

VALTER MEMISHA

**RRETH MBIEMRAVE PREJPJESORË NË SHQIPE  
DHE NË GREQISHTE**

Shqipja dhe greqishtja janë dy nga gjuhët më të vjetra dhe me kontakte të pandërprera shumëshekullore. Ato kanë përbashkësi që kanë lindur në kushte dhe nga faktorë të ndryshëm<sup>1</sup>, por kuptohet vetiu se si gjuhë që formojnë degë të veçanta brenda familjes indoevropiane, shpërfaqin edhe dallime.

Në këtë artikull jemi ndalur te grupi paradigmatic *i mbiemrave prejppjesorë*, sepse në secilën nga të dyja gjuhët këta mbiemra shfaqen deri diku me veçanti leksikore e semantike dhe, së shumti, me veçanti morfologjike.

Në shqipe dhe në greqishte (sidomos në shqipe), grupi i mbiemrave prejppjesorë gjallon brenda klasës leksiko - gramatikore të mbiemrave, si një grup sistemor e me tipare që e dallojnë atë në dy kahe: ndaj grupeve të tjera paradigmatiche mbiemërore, si dhe ndaj pjesoreve të foljeve prej nga ata janë formuar.

1. Mbiemrin prejppjesor e ndeshim në gjuhë të tjera indoevropiane, si në **anglishte** *broken (i thyer) (broken arm - krah i thyer, broken marriage - martesë “e thyer”, e prishur), fallen (i rënë) (fallen leaves - gjethe të rëna, fallen woman - grua “e rënë”, e shthurur), forced (i forcuar) (forced smile - qeshje e sforcuar), known (i njohur) (the known world - botë e njohur, known criminal - kriminel i njohur) etj.*<sup>2</sup>; në **italishte** *disperato (i dëshpëruar) (disperato gesto - gjest i dëshpëruar, tentativo disperato - përpjekje e dëshpëruar, pianto disperato - vajtim i dëshpëruar), fatto (i bërë) (ben fatto - i bërë mirë, frutti fatti / fruta të bërë, të pjekur, letto fatto - shtrat i rregulluar), fidanzato (i fejuar), imbronciato (i vrenjtur) (tempo imbronciato - kohë e vrenjtur), etj.*<sup>3</sup>; në **rusishte** *rasterjannij (i hutuar) (rasterjannij vid – pamje e hutuar), sderzhannij (i përmbajtur) (sderzhannij çellavjek - njeri i përmbajtur,*

<sup>1</sup> Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Tiranë, 2004,

<sup>2</sup> *The New Oxford Dictionary of English*, Oxford, 1999

<sup>3</sup> N. Zingarelli, *Vocabolario della lingua italiana*, Bologna, 1999

*sderzhannij karakter - karakter i përmbajtur), vzolnovannij (i shqetësuar) (vzolnovannij vid - pamje e shqetësuar, vzolnovannij gollos - zë i shqetësuar), umerennij (i matur) (umerennij appetit - oreks i matur, umerennaja politika - politikë e matur) etj.*<sup>4</sup>

2. Semantikisht mbiemrat prejppjesorë shënojnë **tiparin e rezultatit të veprimit** të shprehur prej foljeve, nga tema e së cilëve formohen. Përgjithësisht, këta mbiemra janë cilësorë dhe kategorialiteti i kuptimit të tyre, si i tillë, mbetet i pandryshueshëm. Edhe nëse kanë zhvillime kuptimore brenda strukturës së tyre, duke e zgjeruar aftësinë shënjuese (sidomos përmes rritjes së figurshmërisë e të abstragimit semantik, çka kushtëzon më së shumti edhe shkëputjen nga pjesorja - folje), ata mbeten përsëri cilësorë.

Mbiemrat prejppjesorë trashëgojnë bërthamën kuptimore të foljeve përkatëse. Kjo dukuri formon **kategorialitet** në semantikën e tyre, çka në fjalorët shpjegues përgjithësisht kushtëzon dhënien, ndërtimin dhe strukturimin e kuptimit a të kuptimeve të tyre. Kështu, në shqipe gjejmë formulën shpjeguese *që + kohën e kryer të foljes në pjesore*, nëse mbiemri ka kuptim pjesor: *i mbyllur – që është mbyllur, i hapur – që është hapur* etj. Nëse mbiemri ka kuptim vepror, zakonisht jepet me formulën shpjeguese *që + kohën e kryer të foljes në veprorë, i shëtitur - që ka shëtitur (shumë vende etj.)*. Në këtë grup mund të gjejmë edhe mbiemra që e zbërthehen me *që + folje: i fjetur – që fle, i ditur – që di* etj.

Gjallimi i mbiemrave prejppjesorë si grup i veçantë paradigmantik, brenda grupit të mbiemrave prejfoljorë<sup>5</sup>, ka kushtëzuar dhe studime të ndryshme, të pjesshme a të plota, por ata nuk anashkalohen dhe në gramatika. Ndërsa në greqishte, meqenëse mbiemri përputhet morfematikisht me pjesoren dhe meqenëse kjo “ka lidhje edhe me foljen, edhe me emrin”<sup>6</sup>, gramatikat e fjalorët një- a dy- e shumëgjuhësh nuk e japin këtë grup me përmasat që ka. Ai shpesh lihet i nënkuptuar. Kështu, në shumë fjalorë shpjegues bashkëkohorë, që janë dhe kodifikues të normës leksikore, gjejmë formulën shpjeguese të emrit (jo atë të mbiemrit) dhe shpesh fjala - titull pajiset me elementet plotësuese për të treguar se ajo ka përdorim e funksion të dyfishtë, edhe si pjesore, edhe si mbiemër: *μτχ. = μετοχή* (pjesore), *επιθ. = επίθετο* (mbiemër), si

<sup>4</sup> S. I. Ozhegov, *Slllovar russkovo jazika*, Moskva, 1982

<sup>5</sup> Mbiemrat prejfoljorë janë një grup paradigmantik njësisht, që përfshin disa nëngrupe. Shih për këtë *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, Tiranë, 2002.

<sup>6</sup> P. E. Giannakopolou, *Sintaktiko tis neolenikis glossas*, Athina, 1991, f. 315.

κατεψυγμένος, - η, - ο (μτχ. επιθ.): αυτός που έχει καταψυχθεί // ο πολύ παγωμένος (ai që ka ngrirë, shumë i ngrirë, ) κατεψυγμένος ψάρι (peshk i ngrirë) etj.<sup>7</sup>

3. Emërtimi **mbiemër prejppjesor** në të dy gjuhët motivohet strukturalisht nga tema fjalëformuese, sepse mbiemri krijohet nga pjesorja e foljes gjegjëse.

a. Shqipja mbiemrin e ka dyllojësh: të nyjshëm (me nyjë të paravendosur) dhe të panyjshëm, një dukuri që “nuk ka shoqe në asnjë gjuhë tjetër indoevropiane”.<sup>8</sup> Mbiemrat prejppjesorë janë të gjithë të nyjshëm dhe në gramatikat normative e në fjalëformim përfshihen te formimi me nyjëzim.<sup>9</sup>

Formimi i tyre në gjuhën shqipe, në thelb, është një proces dyshkallësh: **folje (pjesore) → mbiemër**, ndonëse emërtimi **mbiemër prejppjesor** të shpie te një proces trishkallësh: **folje → pjesore → mbiemër**. Në këtë gjuhë, edhe pse pjesorja ka funksione sintaksore të shumta dhe mund të shërbejë si temë fjalëformuese, ajo nuk është pjesë e mëvetësishme e ligjëratës, ajo është pjesë e paradigmës së eptimit foljes. Ndaj procesi i krijimit të mbiemrave është dyshkallësh; vetë pjesoret e foljeve i ndërtojnë ata morfologjikisht dhe po semantemat foljore motivojnë drejtpërdrejt strukturën kuptimore të këtyre mbiemrave, çka vërehet qartë kur këta janë shumëkuptimësh (p.sh. në **Fjalorin e shqipes së sotme**, 1984 / 2002, folja **hap** dhe mbiemri **i hapur** janë dhënë përkatësisht me nga 10 kuptime dhe motivimi gati është horizontal).

**Mbiemri morfematikisht është një pjesore e paranyjzuar.** Nyja e paravendosur kryen funksion të dyfishtë: funksionin e formantit fjalëformues, sepse dallon morfematikisht, kategorialisht mbiemrin nga pjesorja, duke realizuar kalimin nga folja (nga pjesorja e saj) te mbiemri. Por njëherazi ajo bëhet edhe shprehëse e kategorive gramatikore të këtij mbiemri: të gjinisë, të numrit, të rasës. Megjithatë, nyja, edhe në këtë grup paradigmatic është një element gramatikor. Ajo fiton aftësi fjalëformuese pikërisht duke ia ndërruar tiparet morfologjike një klase të caktuar fjalësh (më saktë, një klase të caktuar formash), siç janë pjesoret.<sup>10</sup>

<sup>7</sup> Λεζικό της ελληνικής γλώσσας, Πελεκανος, Αθίνα, 1999.

<sup>8</sup> Sh. Demiraj, *Histori e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1988, f. 73.

<sup>9</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, Tiranë, 2002, f. 69.

<sup>10</sup> V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejppjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999, f. 88

b. Në greqishte procesi është më i tejdukshëm, por dukuria është më e ndërlikuar. Procesi i fjalëformimit këtu është **trishkallësh: folje → pjesore → mbiemër**. Pjesorja në këtë gjuhë (ashtu si emri, folja, mbiemri, përemri dhe nyja) është pjesë leksiko - gramatikore e mëvetësishme.<sup>11</sup> Prandaj edhe procesi i formimit është lehtësisht i shkallëzueshëm. Por ndërlikimi shfaqet në funksionin mbiemëror të pjesores (krahas funksioneve të tjera të shumta, si edhe në shqipe). Pjesorja, thjesht, duke ndryshuar kategoremën leksikore, përdoret si mbiemër. **Mbiemri prejpjesor është i njëjtë morfematikisht me pjesoren**. Nevojat e praktikës së komunikimit gjuhësor të greqishtfolësit, nuk kanë kërkuar domosdoshmërisht njësi të dallueshme mbiemërore. Megjithatë ky lloj mbiemri në këtë gjuhë është një realitet, ashtu si në gjuhë të tjera (si në anglishte, italishte, rusishte, frëngjishte, shembuj nga mbiemrat e të cilave sollëm në fillim të artikullit etj.) ku shfaqet e njëjta dukuri. Si në shqipe, por në një pikë tjetër, veçantia e përputhjes morfemore me pjesoren e redukton procesin fjalëformues (por jo atë motivues, semantik e funksionor), e kthen atë nga proces trishkallësh në dyshkallësh: **folje → pjesore (mbiemër)**. Sintagmatika, shpesh, përcakton njërin nga funksionet e dyfishta të pjesores, funksionin mbiemëror. P.sh., *Μιλουν σιγα η σωπαινουν με τα ματια στηλωμένα στην κλειστη πορτα. / Flisnin ngadalë dhe me zë të ulët me sytë hedhur nga dera. (pjesore) (N. Καζανατζακη, Αγγλια); ... Και κοιταζει αδιαφοροσ τα κανονια, τις κοτελεσ, τα κικτρινισμένα δεντρα. / ...Dhe shikonte moskokëçarës... kotelet, pemët e zverdhura. (mbiemër) (N. Καζανατζακη, Αγγλια) etj.*

4. Shqipja dhe greqishtja dallohen edhe nga lloji i pjesores që motivon morfematikisht dhe semantikisht mbiemrin. Shqipja, si është parë nga shumë studiues, ka vetëm pjesore pësore të së shkuarës<sup>12</sup>, kurse greqishtja e re, edhe pse “nuk e ka llojshmërinë e pjesoreve të greqishtes së vjetër”<sup>13</sup>, është më e pasur me këto forma sesa shqipja. Në greqishten e re, një folje zakonisht ka dy pjesore: pjesoren e së tashmes, që mund të jetë **veprore** (*ενεργητική μετοχή*) dhe **pësore** (*παθητική μετοχή*), si edhe pjesoren e së kryerës, që mund të jetë **pësore**. **Pjesorja pësore e**

<sup>11</sup> M. A. Triandafilidhis, *Gramatikë e vogël e greqishtes së re*, Selanik, 1995, f. 108.

<sup>12</sup> F. Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1988, f. 177.

<sup>13</sup> P. E. Giannakopolou, *Sintaktiko tis neolenikis glossas*, Athina, 1991, f. 316.

greqishtes së re, që është formë e thjeshtëzuar e asaj të greqishtes së vjetër (γεγραμμένος - γραμμένος / i shkruar), është shpesh e njëvlefshme me një mbiemër.

Pjesorja e së tashmes pësore formohet me prapashtesat **-amenos (-άμενος)** *τρεμάμενος* / i dridhur (*τρεμάμενα χείλη* - buzë të dridhura, **-umenos (-ούμενος)** *φοβούμενος* / i trembur (*φοβούμενος παιδί* - fëmijë i trembur) - **omenos (-όμενος)** *εργαζόμενος* / i lodhur (*εργαζόμενες γυναίκες* - gra të lodhura), ndërsa pjesorja e së kryerës pësore formohet me **-menos (-μένος)** *ρημαγμένος* / i shkatërruar (*ρημαγμένα χωριά* - fshatra të shkatërruara) etj.<sup>14</sup>

Këto forma pjesorësh, në shembujt ilustrues, shfaqen si mbiemra prejppjesorë.

5. Shqipja dhe greqishtja, si shumë gjuhë të tjera, foljet i kanë kalimtare dhe jokalimtare. Potencialisht nga çdo folje mund të krijohen mbiemra prejppjesorë, qoftë dhe për arsyen e thjeshtë se çdo folje ka pjesore dhe kjo pjesore mund të kthehet në mbiemër ose të formojë mbiemër. Në shumë gjuhë i.e., ndër to edhe në shqipe e në greqishte, foljet kalimtare (gr. *μεταβατικό ρήμα*) krijojnë lehtësisht mbiemra të tillë. Mundësia për formime të tilla sipas kuptimit të parë të foljes përkatëse është reale, mundësia është gati e njëjtë me realizimin.<sup>15</sup> Kur mbiemrat prejppjesorë formohen nga pjesoret e foljeve kalimtare, ata përgjithësisht kanë kuptim pësor, si *fitilloj* - i filluar, *birësoj* - i birësuar, *korr* - i korrur, *hap* - i hapur, *zhvesh* - i zhveshur etj. në gjuhën shqipe; *λέγω* - *λεγόμενος* / *ειπωμένος* (*them* - i thënë, *i zënë në gojë*), *φαγωμένος* (*ha* - i gërryer, *i ngënë*), *ζηλώνω* - *ζηλωμένος* (*shqer* - i shqerur), *περισπώ* - *περισπώμενη* (*λεζή*) (*theksoj* - i theksuar), *κατηγορώ* - *κατηγορούμενος* (*akuzoj* - i akuzuar), *παγώνω* - *παγωμένος* (*ngrij* - i ngrirë) në greqishte etj.

Mbiemra të këtij lloji krijohen edhe nga pjesoret e foljeve jokalimtare (gr. *αμετάβατο ρήμα*) dhe ata përgjithësisht kanë kuptim vepror. Numerikisht mbiemrat e formuar nga këto folje janë më të paktë se grupi i mësipërm, sepse në të dyja gjuhët edhe foljet jokalimtare janë më të pakta se ato kalimtares, si *vdes* - i vdekur / *πεθαίνω* - *πεθαμένος*, *qesh* - i qeshur / *γελώ* - *γελούμενος*, *gëzoi* - i gëzuar / *χαίρω* - *χαίράμενος* etj.

<sup>14</sup> M. A. Triandafilidhis, *Gramatikë e vogël e greqishtes së re*, Selanik, 1995, f. 234.

<sup>15</sup> J. Thomaj, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992, f. 86.

Por në të dyja gjuhët, disa folje jokalimtare nuk formojnë mbiemra prejpjesorë ose nuk e përdorin pjesoren me vlerë mbiemërore, çka kushtëzohet nga faktorë semantikë, gramatikorë, stilistikë, fjalëformues, paradigmantikë etj.; mundësitë e kalimit nga pjesorja te mbiemri tek ato është në të vërtetë fiktive<sup>16</sup>, si *mbretëroj* - \**i mbretëruar* / βασιλεύω - \*βασιλεμένος, *udhëtoj* - \**i udhëtuar* / ταξιδεύω - ταξιδεμένος etj.

Në greqishte kemi mbiemra që “formohen nga folje kalimtare që përdoren edhe si jokalimtare (*αλλάζω* / *ndërroj* (*edhe moti*) - *αλλαγμένος* / *i ndërruar*), apo nga folje jokalimtare që përdoren si kalimtare” (*μεθύω* / *dehem* - *μεθυσμένης* / *i dehur*)<sup>17</sup>. Kjo dukuri është shumë e përhapur në gjuhën shqipe. Një numër i madh foljesh në gjuhën shqipe janë shumëkuptimëshe dhe në strukturat kuptimore të tyre i gjejmë këto përdorimet dyshe, madje edhe më të gjera.<sup>18</sup> Ashtu si në greqishte, edhe në shqipe mbiemrat e sapoformuar i mbartin semat përkatëse të këtij kategorialiteti.

Mbiemri në të dyja gjuhët mund të ketë kuptim vepror dhe pësor njëkohësisht. P.sh., *i ditur* - *njeri i ditur* / *është e ditur*, *i rrëmbyer* - *lumë i rrëmbyer* / *që është fëmijë e rrëmbyer* (nga *dikush*) etj. në shqipe; *κερδισμένος* (*i fituar*) / *βρήκα κερδισμένος* - *κερδισμένα λεπτά* (*dola i fituar* - *para të fituara*), *φαγομένος* (*i ngrënë*) - *έφηγε φαγομένος* - *πίτα φαγομένη* (*iku i ngrënë* / *byrek i ngrënë*), *διαβασμένος* (*i mësuar*, *i lexuar*) - *διαβασμένος άνθρωπος* / *διαβασμένο βιβλίο* (*njeri i lexuar* - *libër i lexuar*) etj. në greqishte.

6. Studiuesi J. Thomaj vëren se teorikisht në gjuhën shqipe, me ndihmën e njëjës së përparme çdo pjesore mund të mbiemërzohet, porse praktikisht nuk ndodh kështu. Ka folje, nga pjesoret e të cilave nuk formohen mbiemra, sikundër jo çdo pjesore e paranyjësuar është leksikalizuar si mbiemër.<sup>19</sup> Në këtë prerje, te ky grup paradigmantik leksemash shfaqet një nga dallimet kryesore midis shqipes dhe greqishtes.

Gjendja e mbiemrave prejpjesorë në shqipe, por edhe në greqishte, na del me dy nëngrupe njësisht: grupi i njësive të mëvetësishme që mbartin të gjitha kategoritë e mbiemrave të tjerë dhe nëngrupi i

<sup>16</sup> J. Thomaj, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992, f. 86 .

<sup>17</sup> M. A. Triandafilidhis, *Gramatikë e vogël e greqishtes së re*, Selanik, 1995, f. 234 .

<sup>18</sup> V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999, f. 88.

<sup>19</sup> J. Thomaj, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, f. 163.

mbiemrave “okazionalë”, “kontekstorë”, që ruajnë lidhje me foljet gjegjëse, por që kanë edhe disa kategori gramatikore të mbiemrave cilësorë. Në anglishte përdoret termi *mbiemra qendrorë* për të parët dhe *mbiemra anësorë (margjinalë)* për të dytët.<sup>20</sup>

Mbiemrat e mëvetësishëm karakterizohen nga struktura kuptimore të konsoliduara e të qëndrueshme, nga zgjerimi e nga shumëfishimi i lidhjeve semantike e paradigmatiske, nga zhvillimi dhe nga zgjerimi i valencave fjalëformuese, nga përdorime sintagmatike në ligjërime e stile të ndryshme edhe përtej kufijve të temës foljore fjalëformuese. Ata janë realitete jo vetëm leksikore, por edhe leksikografike. Fjalorë të ndryshëm janë tregues të kësaj gjendjeje.<sup>21</sup>

Pjesorja e greqishtes që ka paradigme eptimi (d.m.th., që lakohet), përputhet morfematisht me mbiemrin përkatës, kurse pjesorja e shqipes që ka formë të ngurosur, diferencohet nga mbiemrin, sepse ky merr një të përparme. Por si në greqishte, edhe në shqipe, një funksion kryesor i pjesores mund të jetë ai i përcaktorit të drejtpërdrejtë të emrit. A. Kostallari shprehet se “ajo shfaqet e polisemantizuar dhe kjo nuk është diçka e rastit, por e ka burimin dhe gjen mbështetje në veçantinë e saj se shtjellohet si një trajtë që ka potencia panmodale ose amodale, shumëdiatazore e shumëkohore në tërësinë e raporteve dhe të funksioneve të saj në gjuhën e gjallë”.<sup>22</sup>

Në greqishte kemi një zgjidhje leksikografike të kushtëzuar nga tradita, duke i dhënë, përgjithësisht, leksemat në fjalë në fjalorët shpjegues apo dy- e shumëgjuhësh brenda një zëri të vetëm, të shoqëruara me elementet plotësuese (*pjesore* dhe *mbiemër*). Duhet të shihet sintagmatika e tyre për të dalluar vlerën mbiemërore. Megjithatë në këta fjalorë pjesorja nuk mungon asnjëherë e për pasojë, potencialisht, edhe mbiemrat prejpesorë.

Ndryshe ndodh në shqipe. Mbiemërzimi i pjesores është një rrugë shumë prodhimtare për pasurimin e klasës së mbiemrave. Por po të ndalemi, sidomos, në ligjërimin e shkruar të dhjetëvjetëshave të fundit, për të parë përmasat, shtrirjen dhe dendurinë e përdorimit të këtyre

<sup>20</sup> R. D. Huddelston, *Introduction to the Grammar of English*, Cambridge, 1988, f. 321.

<sup>21</sup> Shih *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (1980), *Fjalor i shqipes së sotme* (1984, 2002), *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe* (2004), si dhe shumë fjalorë të tjerë dygjuhësh, ku shqipja është gjuhë e parë etj.

<sup>22</sup> A. Kostallari, “Kompozitat dëshirore dhe urdhërore”, në *Studime mbi leksikon dhe fjalëformimin në gjuhën shqipe*, I, Tiranë, 1972, f. 188.

njësive, vërejmë se ky mbiemërzim në shumë raste ka karakter rastësor (çastor) e jo të qëndrueshëm dhe mundësitë e krijimit të mbiemrave prejpjesorë kapërcejnë shpesh edhe përtej rregullsive paradigmatiche (paradigmatike, semantike etj.) të fjalëformimit.

Shumë mbiemra janë çastorë, të pashkëputur nga semantika dhe sintagmatika e foljes dhe homonimizimi i plotë i pjesores së adjektivuar kërkon një përdorim të gjatë të saj në një sintagmë determinative atributive me të përcaktuarin.<sup>23</sup>

Në këto raste mund të flitet për pjesore të mbiemërzuar gramatikisht, sepse ata jo vetëm ruajnë të qartë kuptimin e veprimit sipas foljes, por ruajnë edhe sintagmatikën e saj: lidhen me plotësa vendi, me plotësa kohe, me vepruesin etj. Mbiemrat, në këto raste, janë “kontekstorë”. P.sh.: *Fëmijët të frikësuar nga kafsha, vrapuan në fushë. Këto janë disa shënime për Eskilin të hedhura në kohë të ndryshme. (I. K. Eskili..., 1990, f. 4). Το κεφαλι αφηλα στραμμενο..., γραπωμενο. (Kokën nga lart të kthyer., të mbërthyer.) (Elitis). Είναι ολόψυχα αφοσιωμένος στο δουλειά του. (Ishte i dhënë tërësisht pas punës së tij.). Κάθισε λαχανιασμένος, αφανισμένος απο την κόουραση. (U ul i turbulluar, i dërrmuar nga lodhja.) etj. Megjithatë ndërtime të tilla sintagmatike do të përcaktojnë edhe gjallimin e leksikalizimin përfundimtar për këto krijime dhe mbartjen e tyre nga leksema okazionale, në mbiemra të përhershëm, të vetëqëndrueshëm.*

7. Kur një pjesore në shqipe a në greqishte është apo kthehet në mbiemër? Dukuria është komplekse dhe duhet kundruar nga disa anë.

a. Kristalizimi i kuptimit mbiemëror, d.m.th. fitimi i aftësisë për të shënuar cilësi realiesh e jo veprimesh dhe përdorimi atributiv, si përcaktor të drejtpërdrejtë i një emri përcakton shkëputjen e mbiemrit nga folja: Në shqipe *Nëpër njëërën nga portat do të hynte Oresti me pëlhurën - rrjetë me njolla gjaku të thara. (I. K. Eskili..., f. 83); M'ka korrë arën e punueme, m'ka marrë tokën e trashëgueme. Gj. F. Lahuta..., f. 110) E rrjedh për tatëpjetë prej kulmit qielluar / si breshër i thërrmuar, si lot i përvëluar (L. P. Vepra, f. 63.) etj.*

Në greqishte *Ταίριαζε απόλυτα με το ρημαγμένο σχολείο. (Shkonte përsosur me shkollën e rrënuar). (E. Φ. Εκατο..., φ. 243) Γυρισα γρηγορα και καθισα στην προηγουμενη θεσι μου. (U ktheva shpejt dhe u ula në vendin tim të mëparshëm.) (E. Φ. Εκατο..., φ. 197). Βαπόρι στολισμένο*

<sup>23</sup> A. Kostallari, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore*, në Studime mbi leksikun dhe fjalëformimin në gjuhën shqipe, I, Tiranë, 1972, f. 126 – 127.

*βγαίνει στο βουνό. (Del në mal (si) vapor i stolisur.) (Ελυτης). Είδα γυρίζοντας το κεφάλι τις μαύρες πέτρες **συσπειρωμένες**. (Σεφέρης) / Duke kthyer kokën, pashë të zinj të gurë (të mbledhur) të grumbulluar.*

Mbiemri prejppjesor i mëvetësishëm mund të dalë lehtësisht dhe në funksion të kallëzuesit emëror (σαν κατηγορούμενο) ose në atë të përcaktorit kallëzuesor (σαν κατηγορηματικός προσδιορισμός): në shqipe *Veç një njëri po shoh pa punë dhe të mjerë e **të brengosur / të këputur, të mejtuar, të grisur dhe të reckosur.** (N. F. Bagëti..., f. 75). T'i pushtoj i **llafthuar** ato hapëza mëkate... (L.P. Vepra, f. 181) Djemtë e vajza **të mërguar**, / nëna me lotin pa tharë, / e **nxirosur, e mjeruar, / e kapitur, e harruar, / e uritur, e lënduar, / e djegur, e përvëluar.** (Folk.) etj.*

Në greqishte *Ημουν **ψιλοθυμωμένη** γιατί μου εσπαζαν την απομονωση. (Isha e zemëruar, sepse më prishën vetminë.) (E. Φ. Εκατο..., φ. 12.) Να παω **σχωρημένος**, συνεχισαπτοητος τηφαντασιωση του. (E. Φ. Εκατο..., φ. 177.) (Të shkoj i falur, vazhdoi pa ndërprerje fantazinë e tij.). Να είστε **ευτυχισμένοι και χαιράμενοι!** (Qofshi të lumtur e të gëzuar!). **Στενοχωρημένος** σήμερα ήταν ο πατέρας. (I mërzitur ishte sot babai.) Ο Λαμπρος **τρομασμένος** την κραζει. (Σολωμος) (Llambroja i trembur e fton.). **Πεθαμένος - ξεχασμένος!** / I vdekur, i harruar! Περασμένα – ξεχασμένα / I larguar – i harruar! Βρέθηκε **κρεμασμένος** μέσα στο σπίτι του. / U gjend i varur në shtëpinë e vet. **Απελπισμένο** και **ορφανεμένο** ήταν το δρομάκι. / E dëshpëruar dhe e vetmuar ishte rrugica. etj.*

Në gjuhën shqipe si mbiemri prejppjesor ashtu edhe pjesorja dalin edhe në funksione të njëjta, duke krijuar mundësinë e ndërkëmbimit me njëri - tjetrin: *E gjeti derën hapur / të hapur.* Pjesorja në shqipe formon edhe format foljore të kohëve të përbëra. Ndonjëherë ky funksion i saj shpie në një ambiguitet kumtimi, kur në vend të pjesores përdoret mbiemri prejppjesor: *Sofra ishte shtruar / e shtruar.* Kurse greqishtja e dallon qartë mbiemrin nga kohët e përbëra të kallëzuesit *H σουφρα ηταν στρωμενο (Sofra ishte e shtruar.) etj.*

b. Mbiemri prejppjesor i mëvetësishëm vendos lidhje paradigmatiche kuptimore të larmishme me mbiemra të tjerë (kemi bashkëpërdorime të tyre me mbiemra jofoljorë), të kushtëzuara a të pakushtëzuara, si marrëdhënie sinonimike, antonimike, zgjeron aftësinë shënuese etj. Në shqipe p.sh., *i hapur* me rreth 25 kuptime, hyn në sinonimi me *i çelur, i ngritur, i shtrirë, i tendosur, i kthjellët, i drejtpërdrejtë* etj.; në antonimi me *i mbyllur, i errët, i fshehtë, i mbledhur* etj. Në greqishte *λαβωμενος (i plagosur)* hyn në sinonimi me *πληγωμενος, τραυματισμενος, τραυματιας;*

*Αφηρημενος* (*i hutuar*) hyn në sinonimi me *απρόσεκτος*, *ανεικονικός*, *αποξασμένος* e në antonimi me *συγκεκριμένος*, *ορισμένος*, *ζεκάθαρος*, *ευκρινής*. Ky mbiemër, si shumë të tjerë, është polisemantik *αφηρημένος άνθρωπος* / *αφηρημένη έννοια* / *αφηρημένο όνομα* / *αφηρημένος αριθμός* (përkatësisht *njeri i hutuar* / *kuptim abstrakt* / *emër abstrakt* / *numër abstrakt*). Mbiemrat dalin në të dy gjuhët me kuptime konkrete e të figurshme, me kuptime të parme (të parë të shkëputur nga folja gjegjëse) dhe me kuptime të prejardhura. Kjo do të thotë që ata hyjnë në marrëdhënie sintagmatike të larmishme dhe të ndryshme nga ato të pjesoreve (foljeve) dhe mëvetësohen prej tyre. P.sh. *Νjë këנגë e llaftuar po vjen prej lartësish.* (L. P. Vepra, f. 180). *Ah! Kjo këנגë e djegur e ligjërimin tënd!* (L. P. Vepra, f. 150). *O këנגë e shenjtëruar, o verb i larë në ar!* (L. P. Vepra, f. 60).

c. Mbiemrat e shkëputur nga pjesorja, si në greqishte dhe në shqipe e kanë të shkallëzueshëm tiparin, cilësinë që shënojnë. Në të dy gjuhët, për të shprehur dallimin e shkallëve të këto njësi, përdoren trajta perifrastike. Tregues bëhen ndajfoljet e sasisë **më / πιο, shumë / πολη**: *χαρούμενος* / *πιο χαρούμενος* / *ο πιο χαρούμενος* / *πολυ χαρούμενος* – *i gëzuar* / *më i gëzuar* / *më i gëzuar* / *shumë i gëzuar* (përkatësisht në shkallën pohore, krahasore, sipërore relative, sipërore absolute). P.sh., *Foli Kryeprihti i madh* / *shumë i madh e shumë i ditur.* (L. P. Vepra, f. 311). *Shpirti im i nxirë krejt / do më lërë me pahir.* (L. P. Vepra, f. 147). *N'atë vajtim aq të lënduar / q'e thuri gjuha jote e zjarrtë.* (L. P. Vepra, f. 70). *Η γυναίκα ήταν πολη παραγμένη.* (Gruaja ishte shumë e trembur). *Το πρωί ζύπνησε πιο ησυχασμένη.* (Në mëngjes u zgjua më e qetësuar.) etj.

7. Mbiemrat prejpjesorë në shqipe dhe në greqishte krijojnë fjalë të reja, ata shërbejnë si tema fjalëformuese e si semantema për njësi të tjera të vargjeve paradigmatiske fjalëformuese. Dh. Qiriazi p.sh., shprehet se “duke krahasuar dy gjuhët, vëmë re se greqishtja paraqet një numër më të madh kompozitash dëshirore dhe aktivizon një gamë më të madhe foljesh në mbiemrat e saj prejpjesorë (Andhriotis, 1932), kurse në shqipe numri i tyre është i kufizuar. Të krahasohen njësi si p. sh. *pikërrënë, pikërrarë* dhe *πικοβαρεμένος* si dhe *αστραπουβαρεμένος* / *αστραπουκαμένος* që nuk kanë struktura gjegjëse në shqipe (\*rruferënë, \*rrufedjegur)<sup>24</sup> (në shqipe përmendim dhjetëra mbiemra me kuptim mohor, qindra kompozita

<sup>24</sup> *Shih më gjerë* Dh. Qiriazi, “Ndikime të shoqishoqshme apo zhvillime paralele?” në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën kombëtare*, 22/1, Prishtinë, 2004, f. 254.

determinative etj., kompozita që në greqishte formojnë një grup paradigmatic vëllimor) dhe janë lehtësisht të emërzueshëm. Psh. Në shqipe *i vrrarë – i pavrrarë, i vjelë - i pavjelë, i hekurosur – i pahekurosur, i përlyer – i papërlyer, i arrirë - i paarrirë* etj.; në greqishte *αραιοκατοικημένος ← αραίό + κατοικημένος, πυκνοκατοικημένος ← πυκνό + κατοικημένος* etj.

Mbiemrat prejpsorë, si në shqipe, ashtu dhe në greqishte, hyjnë në përbërje të njësive frazeologjike e të idiomave etj. si *teneqe e shpuar / τενεκές σπασμένος - σπασμένο λεγέμι, me gjak të ngrirë / με παγωμένο αίμα me buzë të plasur / με σουφρωμένα χείλι, i qepur me pe të bardhë / ραμένο με άσπρο ρόμμα* etj.<sup>25</sup>

8. Problemi që trajtuam, ndër të tjera, e ka marrë shtysën edhe nga praktika leksikografike dygjuhëshe, sidomos nga puna me fjalorët greqisht - shqip. Meqenëse shqipja ka shumë mbiemra prejpsorë, në një fjalor dygjuhësh (shqip - greqisht / greqisht – shqip) ajo do të kërkojë të njëjtën leksemë korrelative në greqishte (çka nuk lind midis greqishtes dhe gjuhëve të tjera). Hartues të ndryshëm fjalorësh, leksikografë profesionistë ose amatorë të leksikografisë, sidomos këta dhjetë – pesëmbëdhjetë vjetët e fundit, janë përpjekur të bëjnë zgjidhje të mesme, por më së shumti zgjidhje të kushtëzuara nga stuktura leksemore e njëres apo e tjetres gjuhë. Përmendim këtu fjalorin Ελληνο - αλβανικο λεξικο të N. Gjinit (me rreth 50.000 leksema)<sup>26</sup>, fjalorin Ελληνο - αλβανικο λεξικο të H. Sinanit (me rreth 20.000 leksema)<sup>27</sup> etj., në të cilët shumë pjesore të greqishtes (si gjuhë e parë) janë dhënë në shqipe me barasvlerësin e tyre mbiemër prejpsor. Nganjëherë mund të gjejmë raste kur dy mbiemra, njëri prejfoljor e tjetri prejpsor përkthehen në shqipe vetëm me një mbiemër prejpsor, si *γραμμένος / γραπτός → i shkruar; κλεισμένος / κλειστός → i mbyllur* etj.

Dy dhjetëvjetëshat e fundit, kontaktet gjuhësore ndërmjet shqiptarëve dhe grekëve janë rritur ndjeshëm. Ato kushtëzohen nga faktorë ekonomikë, shoqërorë, politikë, kulturorë, shkencorë etj. Shpesh, gjatë komunikimeve gjuhësore dalin probleme që lidhen drejtpërdrejt me zotërimin e greqishtes nga shqipfolësit dhe të shqipes nga greqishtfolësit. Nga sa parashtruam në këtë artikull, mendojmë se edhe njohja e veçantive të mbiemrave prejpsorë në secilën gjuhë lehtëson të nxënë

<sup>25</sup> *Fjalor Frazeologjik Ballkanik*, Tiranë, 1999.

<sup>26</sup> Ν. Γκινι, *Ελληνο - αλβανικο λεξικο*, Ιωαννινα, 1993.

<sup>27</sup> Η. Σινανι, *Ελληνο - αλβανικο λεξικο*, Tirana, 2001.

në shkolla, komunikimet e përditshme gjuhësore, përkthimet e të gjitha fushave si dhe punën leksikografike.

### FJALORË TË PËRZGJEDHUR

- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980.  
*Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 1984 / 2002.  
*Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.  
*Fjalor frazeologjik Ballkanik*, Tiranë, 1999.  
*Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.  
*Λεξικό της ελληνικής γλώσσας*, Πελεκανος, Αθηνά, 1999.  
 Γκινη, Ν: *Ελληνο - αλβανικό λεξικό*, Ιωαννίνα, 1993.  
 Ozhegov, S.I.; *Slovar russkovo jazika*, Moskva, 1982.  
 Sinani, H.: *Ελληνο - αλβανικό λεξικό*, Tίrana, 2001.  
*The New Oxford Dictionary of English*, Oxford, 1999.  
 Zingarelli, N.: *Vocabolario della lingua italiana*, Bologna, 1999

### BIBLIOGRAFI

- Agalliu, Fatmir: *Çështje të morfologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1988.  
 Kostallari, Androkli: *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore*, në *Studime mbi leksikon dhe fjalëformimin në gjuhën shqipe*, I, Tiranë, 1972.  
 Demiraj, Shaban: *Gjuhësi ballkanike*, Tiranë, 2004.  
 Demiraj, Shaban: *Histori e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1988.  
 Giannakopolou, P.E. : *Sintaktiko tis neolenikis glossas*, Athina, 1991.  
*Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, Tiranë, 2002.  
 Huddelston, R.D.: *Introduction to the Grammar of English*, Cambridge, 1988.  
 Memisha, Valter: *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në shqipe*, Gjirokastër, 1999.  
 Qiriazi, Dhori: “Ndikime të shoqishoqshme apo zhvillime paralele?” në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën kombëtare*, 22/1, Prishtinë, 2004.  
 Triandafilidhis, M.A.: *Gramatikë e vogël e greqishtes së re*, Selanik, 1995.  
 Thomaj, Jani: *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999.

Thomaj, Jani: *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992.

*SUMMARY*

*PARTICIPIAL ADJECTIVES IN ALBANIAN AND IN GREEK LANGUAGES*

The class of participial adjectives, a model class and semantically a specialized one flourishes in the Albanian language and in Greek, as well as in the other Indo-European languages. Adjectives of such a type are derived from the participles of the corresponding verbs. In Albanian, this process occurs in two stages: **verb (participle)-adjective**, whereas in Greek it occurs in three stages: **verb-participle-adjective**, for participle is considered as a lexical-grammatical unit.

In both languages there are self-existent adjectives having attributive function and contextual adjectives having predicative function. Semantically these adjectives designate the attribute of an action result expressed by the verb and they may have a passive meaning (*lag - lagur (i) / vrehë - vrehamenos*), but also an active or a reflexive one (*known – who knows; which is known / (kori) zilemeni - (a girl) who envies; which is envied etc.*).

Participial adjectives develop their semantic structures, enter various semantic relations, build up idioms, etc. Morphemically, in Greek, as well as in English, Italian, Russian, etc. they correspond to the participle, whereas in Albanian they differ from participles, for they take a preposed article and the article plays the role a word-formation formant.

In Albanian these adjectives are derived from the past passive participle, usually of transitive verbs, whereas in Greek they are derived from both participles: the present passive participle (with **-amenos, -umenos, -omenos**) and the past passive participle (with **-menos**).

Both in Albanian and in Greek these adjectives are easily nominalized.

